



**Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly**

LEGJISLATURA V

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Mbledhja nr. 22

Prishtinë, më 23.09.2015 ora: 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-I

Procesverbal

i mbledhjes së Komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti, Sadri Ferati, Kujtim Paçaku, Xhevahire Izmaku, Alma Lama, Shqipe Pantina, Pal Lekaj dhe Zafir Berisha.

Mungoi: Jelena Bontiq.

Në mbledhje morën pjesë përfaqësuesit e : KDI, OSCE si dhe Falmur Hyseni, ekspert i Komisionit.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Drita Morina dhe Mirjeta Heta.

Mbledhjen e kryesoi: Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje është propozuar ky rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i Projektligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative;**
- 3. Shqyrtimi i agjendës lidhur me monitorimin e ligjeve në procedurë;**
- 4. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua me një ndryshim: pika e tretë, kalon në pikën dy, ndërsa pika e dytë kalon në pikën e tretë të rendit të ditës.

2. Shqyrtimi i agjendës lidhur me monitorimin e ligjeve në procedurë;

Zenun Pajaziti propozoi që deri në fund të vitit kalendarik, të fillohet me monitorimin edhe të një ligji po që se grupet punuese kanë përfunduar me ligjet që janë në monitorim.

Shqipe Pantina e njoftoi komisionin për tryezën e mbajtur, lidhur me monitorimin e Ligjit për OJQ-të dhe propozoi që të bëhen edhe disa vizita në institucionin e ATK-së dhe në dogana, si të domosdoshme për të kuptuar më për së afërmi çështjet që ndërlidhen me funksionimin e OJQ-ve.

Xhevahire Izmaku propozoi që të bëhet një vizitë në Agjencinë e Statistikave dhe që komisioni ti drejtohet përsëri Agjencisë së Statistikave me kërkesë për takim.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative;

Zenun Pajaziti kërkoi nga kryesuesi i grupit punues, z. Sadri Ferati, të fillohet me hartimin e propozim ndryshimeve për P/ligjin për procedurën e përgjithshme administrative.

Sadri Ferati propozoi që të mbahet një punëtori, dy apo tre ditore dhe të gjitha propozimet që i ofrohen komisionit nga grupet e interesit si dhe propozimet e ekspertit z. Flamur Hyseni, të shqyrtohen.

Alma Lama kërkoi nga eksperti, i cili ka hartuar propozim amendamentet për P/ligjin, të hartojë edhe përkufizime për projektligj dhe ato ti nxjerr nga ligji për procedurë administrative të Shqipërisë.

Konstatim – Komisioni miratoi propozimin e sipërshtënuar dhe caktoi datat 25-27.10.2015 për mbajtjen e punëtorisë.

4. Të ndryshme.

Pasi për këtë pikë të rendit të ditës nuk pati diskutime, mbledhja përfundoi.

Mbledhja përfundoi në ora: 14:00.

E përgatiti :

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit
Zenun Pajaziti
